



# UDHËZIME MBI NDIHMËN JURIDIKE MIQËSORE PËR FËMIJËT

UNICEF ECARO, Tetor 2018

## FALENDERIME

Këto Udhëzime u hartuan nga Zyra Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore e UNICEF-it (ECARO). Për këto Udhëzime, UNICEF ECARO dëshiron të falënderojë autoren Frances Sheahan dhe pikat fokale në zyrat e UNICEF-it në vendet e rajonit. Mbi të gjitha, u jemi mirënjohës profesionistëve ligjorë nga 12 shtete të këtij rajoni, të cilët dhanë kontribut të madh në përmbajtjen e këtyre Udhëzimeve nëpërmjet pjesëmarrjes entuziaste në ushtrimet hartëzuese, konsultimet, rishikimet dhe pilotimin e Udhëzimeve në punën e tyre të përditshme.

Botimi në gjuhën shqipe i Udhëzimeve u realizua nga Zyra e UNICEF-it në Shqipëri, përmes Fondit të Përsheptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB Shqipëri.



Norwegian Embassy



UNITED NATIONS  
ALBANIA





# UDHËZIME MBI NDIHMËN JURIDIKE MIQËSORE PËR FËMIJËT

UNICEF ECARO, Tetor 2018



# PËRMBAJTJA

|  |           |
|--|-----------|
| <b>TERMINOLOGJIA</b>   | <b>6</b>  |
| <b>HYRJE</b>   | <b>8</b>  |
| <b>PARIMET E PËRGJITHSHME</b>  | <b>10</b> |
| <b>UDHËZIMET MBI NDIHMËN JURIDIKE MIQËSORE PËR FËMIJËT</b>                                 | <b>13</b> |
| <b>UDHËZIMI 1:</b> Kompetenca gjatë dhënies së ndihmës juridike për fëmijët                | 14        |
| <b>UDHËZIMI 2:</b> Veprimi në interesin më të lartë të fëmijës                             | 15        |
| <b>UDHËZIMI 3:</b> Pjesëmarrja efektive  | 17        |
| <b>UDHËZIMI 4:</b> Ndërtimi i marrëdhënies   | 19        |
| <b>UDHËZIMI 5:</b> Komunikimi i ndjeshëm ndaj fëmijëve                                     | 21        |
| <b>UDHËZIMI 6:</b> Dhënia e informacionit të besueshëm dhe të përshtatshëm                 | 25        |
| <b>UDHËZIMI 7:</b> Pjesëmarrja efektive në proceset formale                                | 27        |
| <b>UDHËZIMI 8:</b> Bashkëpunimi me pjesëtarë të familjes dhe të rritur të tjerë mbështetës | 29        |
| <b>UDHËZIMI 9:</b> Jeta private dhe konfidencialiteti                                      | 30        |
| <b>UDHËZIMI 10:</b> Mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi                                   | 32        |
| <b>UDHËZIMI 11:</b> Mbajtja e fëmijëve të sigurt   | 34        |
| <b>UDHËZIMI 12:</b> Bashkëpunimi me të tjerët  | 35        |
| <b>BURIME DHE LEXIME TË MËTEJSHME</b>  | <b>36</b> |

# TERMINOLOGJIA

**Qasja në drejtësi:** 'Qasja në drejtësi mund të përkufizohet si mundësia për të përfutur zgjidhje të drejtë dhe në kohë për shkeljet e të drejtave, sipas përcaktimeve në normat dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare (përfshirë dhe KDF).

Mungesa e qasjes në drejtësi është një karakteristikë e qartë e varfërisë, por edhe një pengesë për çrrënjosjen e varfërisë dhe pabarazisë gjinore ... Qasja e duhur në drejtësi kërkon fuqizimin ligjor të të gjithë fëmijëve: të gjithë duhet të kenë mundësi të kërkojnë të drejtat e tyre, përmes shërbimeve juridike dhe të tjera, si edukimi ligjor për të drejtat e fëmijës apo këshillimi dhe mbështetja e tyre nga të rritur me njohuritë përkatëse.'

*Burimi: Qasja e përbashkët e OKB-së ndaj Drejtësisë për Fëmijët (2008)*

**Fëmijë:** çdo individ nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, i mitur.

*Burimi: Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (1989), Neni 1*

**Drejtësia miqësore për fëmijët:** 'i referohet sistemeve të drejtësisë që garantojnë respektimin dhe zbatimin e efektshëm të të gjitha të drejtave të fëmijës, në masën më të madhe të arritshme... Në veçanti, është drejtësia që është e aksesueshme, e përputhur me moshën, e shpejtë, e zellshme, e përshtatur dhe e përqendruar në nevojat e fëmijës, përfshirë të drejtat për një proces të rregullt, për të marrë pjesë në dhe për ta kuptuar procesin, për respektimin e jetës private dhe familjare dhe për integritet e dinjitet.'

*Burimi: Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët (2010), II c*

**Fëmijë në konflikt me ligjin:** 'një fëmijë që dyshohet, është i akuzuar, ose pranohet se ka shkelur ligjin penal pas mbushjes së moshës së përgjegjësisë penale, dhe përpara se të ketë mbushur moshën 18-vjeçare.'

*Burimi: Drejtësia në Çështje që Përfshijnë Fëmijët në Konflikt me Ligjin: Ligji Model për Drejtësinë për të Mitur dhe Komentari Përkatës, UNODC (2013)*

**Shmangia:** 'Kanalizimi i kushtëzuar i fëmijëve në konflikt me ligjin, larg nga procedurat gjyqësore përmes krijimit dhe zbatimit të procedurave, strukturave dhe programeve që u mundësojnë shumë individëve, në mos shumicës prej tyre, të trajtohen nga organe jogjyqësore, duke shmangur kështu efektet negative të procesit formal gjyqësor dhe historikut penal.'

*Burimi: Grupi i Instrumenteve për Shmangien dhe Alternativat ndaj Burgimit, UNICEF (2010)*

**Profesionist ligjor:** Për qëllime të këtyre Udhëzimeve, "profesionist ligjor" është çdo individ i kualifikuar, i cili sipas legjislationit kombëtar gëzon të drejtën për të ofruar këshillim, ndihmë dhe përfaqësim juridik.

---

**Ndihmë juridike:** Për qëllime të këtyre Udhëzimeve, “ndihmë juridike” përfshin këshillimin, ndihmën dhe përfaqësimin juridik/ligjor për fëmijët.

**Prind(ër)** ‘i referohet individit/individëve me përgjegjësi prindërore, sipas legjislacionit kombëtar. Nëse prindi(ërit) nuk është/janë të pranishëm, ose nuk mbajnë më përgjegjësi prindërore, ky individ mund të jetë një kujdestar ose një përfaqësues ligjor i autorizuar.’

*Burimi: Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët (2010), II b*

**Drejtësia restauruese / procesi i drejtësisë restauruese** ‘çdo proces gjatë të cilit viktimë, autori dhe/ose individë të tjerë apo pjesëtarë të tjerë të komunitetit të ndikuar nga një veprë penale, marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive në gjetjen e zgjidhjes së çështjeve që lindin nga vepra penale, shpesh me ndihmën e një pale të tretë, të drejtë dhe të paanshme. Shembuj të procesit të drejtësisë restauruese përfshijnë ndërmjetësimin, konferencat ndërmjetësuese dhe rrethet e dënimit.’

*Burimi: Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara për Përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese në Çështje Penale (2000)*

**Viktimizim dytësor:** ‘viktimizimi që ndodh jo si pasojë e drejtpërdrejtë e veprës penale, por përmes reagimit të institucioneve dhe individëve ndaj viktimës.’

*Burimi: Drejtësia në Çështje që Përfshijnë Fëmijët në Konflikt me Ligjin: Ligji Model për Drejtësinë për të Mitur dhe Komentari Përkatës, UNODC (2009)*

# HYRJE

Fëmijët hyjnë në kontakt me ligjin për arsye të ndryshme, si të pandehur apo dëshmitarë në procedime penale; si palë në procese të çështjeve familjare; si viktimë të dhunës fizike a psikologjike, abuzimit seksual apo krimeve ose shkeljeve të tjera të të drejtave; dhe si palë në procese civile ose administrative për çështje që përfshijnë kujdesin shëndetësor, sigurimet shoqërore, aftësinë e kufizuar dhe kërkesat për azil apo strehim si refugjatë. Rezultatet e këtyre çështjeve mund të jenë tepër të rëndësishme për jetën e fëmijëve, si në aspektin afatshkurtër ashtu dhe në atë afatgjatë. Ato mund të përcaktojnë nëse fëmijët do të burgosen apo jo, me kë do të jetojnë, çfarë kontakti mund të kenë me prindërit apo motrat e vëllezërit e tyre, në cilin shtet do të jetojnë dhe çfarë shkolle do të ndjekin.

Shumicës së fëmijëve që hyjnë në kontakt me ligjin, përvoja e proceseve ligjore iu duket konfuzë, në rastin më të mirë, dhe si burim frike, ankthi dhe viktimizimi dytësor, në rastin më të keq. Nuk është e pazakontë që ata ta kenë të vështirë të komunikojnë me të rriturit e përfshirë në këto procese, apo të jenë mosbesues ndaj policisë dhe gjyqtarëve, të kenë mungesë informacioni dhe kuptueshmërie lidhur me proceset dhe procedurat, apo të hasin diskriminim për shkak të moshës, gjinisë ose karakteristikave të tjera, si për shembull: pse jeton apo punon në rrugë apo pse është azilkërkues. Rikujtimi i ngjarjeve të dhimbshme mund të jetë shumë stresuese për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, dhe nëse procedura ligjore nuk është e ndjeshme ndaj fëmijës, ajo mund të ketë pasoja afatgjata dhe të dëmshme për rikuperimin e tyre. Megjithatë, shumë sisteme ligjore nuk bëjnë asgjë, ose bëjnë shumë pak, për t'iu mundësuar fëmijëve pjesëmarrje të sigurtë, kuptimplotë dhe dinjitoze në proceset ligjore.

Një hap i rëndësishëm për ngritjen e një sistemi drejtësie miqësor me fëmijët është që fëmijët të kenë mundësi për të marrë mbështetje nga profesionistë ligjorë ekspertë, të specializuar dhe të besuar. Këta profesionistë mund të kenë ndikim shumë të madh në përvojën e fëmijës me sistemin e drejtësisë si dhe në rezultatet e çështjes.

Në vitin 2015, Zyra Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore e UNICEF-it (UNICEF ECARO) kreu një studim mbi qasjen e fëmijëve në drejtësi (*Mundësi të barabarta për fëmijët për të kërkuar drejtësi: Rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe i Azisë Qendrore, UNICEF, Gjenevë, 2015*). Një prej gjetjeve të studimit ishte mungesa e udhëzimeve për profesionistët ligjorë të rajonit kur t'iu ofronin fëmijëve mbështetje dhe ndihmë për qasje në drejtësi. Në përgjigje të kësaj, janë krijuar këto Udhëzime, me qëllim që të shërbejnë si një mjet praktik për të mbështetur si profesionistët ligjorë me përvojë, ashtu edhe ata të rinj, në punën e tyre të përditshme në vijën e parë të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Udhëzimet iu drejtohen avokatëve, paraligjorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë, si privatë, ashtu edhe të financuar nga shteti, të cilët iu mundësojnë fëmijëve ndihmë juridike në proceset e drejtësisë civile, penale, administrative dhe restauruese, dhe të cilët i përfaqësojnë ata në çështjet e adresuara nga organet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të monitorimit të të drejtave të njeriut. Kryesisht, udhëzimet iu drejtohen profesionistëve që përfaqësojnë drejtpërdrejt fëmijët dhe jo avokatëve që përfaqësojnë fëmijën si kujdestarë të pavarur apo "miq" të gjykatës.

Udhëzimet përqendrohen në qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme që një fëmijë klient të mund të marrë përfaqësimin juridik dhe mbështetjen më të mirë të mundshme. Ato marrin parasysh faktin që, shpesh, profesionistët ligjorë punojnë në sisteme drejtësie jo të përkryera dhe se iu duhet të përballen me paga të ulëta, legjislacion të papërshtatshëm, vonesa të gjata të proceseve dhe mungesë aksesimi në shërbime miqësore me fëmijët për klientët e tyre.



UNICEF ECARO i hartoi Udhëzimet në bashkëpunim të ngushtë me një rrjet prej 20 profesionistësh ligjorë nga 12 shtete të rajonit. Shpresojmë që këto Udhëzime të jenë të vlefshme dhe për profesionistët në rajone të tjera. Profesionistët ligjorë të përfshirë në hartimin e tyre plotësuan një pyetësor të detajuar mbi përmbajtjen e Udhëzimeve, i pilotuan ato në punën e tyre të përditshme dhe dhanë kontribut të rëndësishëm në hartimin dhe aplikimin e tyre në praktikë. Udhëzimet përfshijnë dhe citate të disa prej këtyre juristëve.

Avokatët në pothuajse çdo juridiksion duhet t'iu përmbahen kodeve profesionale të sjelljes dhe etikës. Parimet më të zakonshme në mbarë botën janë ato që kërkojnë nga avokatët të veprojnë me ndershmëri dhe integritet, të veprojnë në interesin më të lartë të klientëve të tyre, të zbatojnë ligjin, të mos veprojnë në raste kur ka konflikt interesi dhe të ruajnë konfidencialitetin e klientëve të tyre. Këto Udhëzime janë hartuar për të plotësuar kodet profesionale dhe për të marrë në konsideratë se si këto kode mund të aplikohen kur bëhet fjalë për fëmijët.

Udhëzimet janë bazuar në standardet ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me qasjen e fëmijëve në drejtësi (ju lutemi të shihni seksionin *Burimet* më poshtë për listën e instrumenteve dhe udhëzimeve përkatëse). Ato nisin me shqyrtimin e katër parimeve të përgjithshme të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, që janë: e drejta për mosdiskriminim; e drejta për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin; e drejta për t'u dëgjuar; dhe parimi që interesi më i lartë i fëmijëve të jetë konsiderata parësore në vendimmarrjen që ka lidhje me ta, si dhe mënyrën se si puna e profesionistëve ligjorë duhet të bazohet në këto parime.

Seksionet vijuese janë strukturuar rreth temave dhe sfidave kyçe që vijnë nga mundësimi i ndihmës juridike miqësore për fëmijët, ku përfshihen: sigurimi i kompetencës për të vepruar, veprimi në interesin më të lartë të fëmijës, komunikimi në mënyrë miqësore me fëmijët, lehtësimi i pjesëmarrjes së fëmijës në procese ligjore, luftimi dhe parandalimi i diskriminimit, siguria e fëmijëve dhe puna me të tjerët. Megjithatë Udhëzimet nuk mund të përshkruajnë çdo situatë apo rrethanë me të cilat përballen profesionistët ligjorë që u ofrojnë fëmijëve ndihmë juridike, shpresojmë që ato të shërbejnë si një kornizë bindëse dhe praktike për veprim, e cila nxit dhe mbështet qasjen e fëmijëve në drejtësi.

# PARIMET E PËRGJITHSHME

Udhëzimet bazohen në katër parimet e përgjithshme, që përbëjnë themelin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në sistemet e drejtësisë. Profesionistët ligjorë duhet t'i marrin parasysh këto parime në të gjitha veprimet që ndikojnë tek fëmijët. Parimet diskutohen sërish në mënyrë më të detajuar tek Udhëzimet, megjithatë në vijim është dhënë një prezantim i shkurtër.

## Mosdiskriminimi

“Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike apo çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij a përfaqësuesve të tij ligjorë.

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura, apo bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.”

*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Neni 2 (1) dhe (2)*

Në çdo fazë të kontaktit të fëmijës me sistemin e drejtësisë, një profesionist ligjor duhet të sigurohet që fëmijës t’i ofrohen shërbimet e duhura pa diskriminim. Secili klient duhet të trajtohet me ndjeshmëri dhe duke i mirëkuptuar problemet që hasin fëmijët, apo grupet e fëmijëve, për shkak të gjinisë, moshës, racës, aftësive të tyre të kufizuara e me radhë. Shumë prej fëmijëve në kontakt me ligjin mund të jenë viktime të diskriminimit, ndaj duhet bërë çdo përpjekje për të parandaluar dhe korrigjuar këtë.

E drejta për mosdiskriminim ka rëndësi të veçantë për profesionistët ligjorë kur iu duhet të merren me grupet e cenushme të fëmijëve në kontakt me ligjin, ku duhet të merren masa të veçanta për të siguruar që të drejtat e tyre të respektohen dhe garantohen në mënyrë të barabartë. Për shembull, fëmijët të cilët flasin gjuhën e një pakice mund të kenë nevojë për një përkthyes gjatë proceseve ligjore.

## Interesi më i lartë

“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore”.

*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Neni 3*

Profesionistët ligjorë kanë një rol të rëndësishëm në garantimin e të drejtës së fëmijëve që interesi i tyre më i lartë të jetë një konsideratë parësore kur ata janë të përfshirë në sistemin e drejtësisë apo preken prej tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo. Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 14 (2013), Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, ofron udhëzime joshteruese mbi faktorët që duhen marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës, ku përfshihen: këndvështrimet e fëmijës; identiteti i fëmijës; ruajtja e mjedisit familjar; kujdesi, mbrojtja dhe siguria e fëmijës; shëndeti i fëmijës; cenusshmëria; dhe e drejta për arsim. Kur vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës, profesionistët ligjorë duhet gjithashtu të marrin parasysh faktin që parimet e tjera të përgjithshme, si mbijetesa dhe zhvillimi, e drejta për t'u dëgjuar dhe mosdiskriminimi, janë të gjitha me rëndësi.

Parimi i interesit më të lartë të një fëmije individual është një koncept dinamik, i cili zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme teksa fëmija rritet dhe rrethanat ndryshojnë. Çdo fëmijë ka të drejtën që interesi i vet më i lartë të jetë konsideratë parësore, por kjo është diçka që duhet balancuar për të mos rënë ndesh me interesat më të larta të fëmijëve të tjerë, grupeve të fëmijëve apo të rriturve, si për shembull të pandehurit në procedime penale apo vëllezërit ose motrat në mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me të drejtën e vizitës dhe mbajtjen e kontaktit me familjarët e tyre.

**“Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës nënkupton, për shembull, që objektivat e zakonshme të drejtësisë penale, si shtypja/shpagimi, duhet t'ia lenë vendin rehabilitimit dhe objektivave të drejtësisë restauruese kur bëhet fjalë për fëmijët që shkelin ligjin”.**

*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës,  
Koment i Përgjithshëm Nr. 10, pika 10.*

## **Mbijetesa dhe zhvillimi**

**“Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës”.**

*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Neni 6 (2)*

Parimi i mbrojtjes të së drejtës së fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim është i lidhur ngushtë me të drejtën e interesit më të lartë të fëmijës. Zbatimi i kësaj të drejte do të thotë mbrojtja e fëmijëve nga dëmtimi që mund t'iu shkaktohet gjatë proceseve ligjore; për shembull, mbrojtja e fëmijëve dëshmitarë nga hakmarrja e keqbërësve dhe/apo garantimi që fëmijët në kontakt me ligjin të kuptojnë qartazi të gjitha fazat e çështjes së tyre. Të gjitha format e privimit nga liria (përfshi arrestimin, paraburgimin, apo burgimin) mund të kenë pasoja negative për mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës. Profesionistët ligjorë duhet të bëjnë çmos, me aq sa kanë në dorë, që privimi i lirisë së fëmijës të përdoret vetëm për një kohë sa më të shkurtër dhe si masë e fundit e mundshme.

## E drejta për t'u dëgjuar

**“Shtetet palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij”.**

*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Neni 12 (1) dhe 12 (2)*

Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohej në çdo procedurë gjyqësore dhe administrative që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt apo nëpërmjet një përfaqësuesi ose organi kompetent, në përputhje me normat procedurale të ligjit kombëtar.

Fëmijët duhet të kenë mundësinë të shprehin pikëpamjet, mendimet dhe shqetësimet e tyre dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive përgjatë gjithë procesit të drejtësisë, për sa kohë kjo të jetë në interesin e tyre më të lartë. Për zbatimin e kësaj, proceset e drejtësisë duhet të jenë posaçërisht të përshtatura për fëmijët, dhe duhet t'u japin fëmijëve informacionin e nevojshëm mbi procesin, zgjedhjet që mund të bëjnë dhe pasojave të mundshme të këtyre zgjedhjeve. E drejta e fëmijës për të heshtur dhe të mos marrë pjesë është po aq e rëndësishme.

Profesionistët ligjorë duhet të vlerësojnë moshën dhe pjekurinë e fëmijës, si dhe peshën relative që iu duhet dhënë pikëpamjeve, mendimeve, shqetësimeve dhe dëshmisë së fëmijës. Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 (2009) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, shpjegon se mosha nuk mjafton për të përcaktuar rëndësinë e pikëpamjeve të fëmijës dhe se informacioni, përvoja, mjedisi, pritshmëritë sociale dhe kulturore, dhe shkalla e mbështetjes, janë të gjithë faktorë që kontribuojnë në zhvillimin e aftësisë së fëmijës për të formuar një pikëpamje.

**“Fëmijët duhet të konsiderohen dhe trajtohen si mbajtës të plotë të të drejtave dhe duhet të kenë të drejtën për të ushtruar të gjitha këto të drejta në një mënyrë të tillë që merr parasysh aftësinë e tyre për të formuar pikëpamje dhe rrethanat e çështjes”.**

*Udhëzime të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijët (2010)*

# UDHËZIME MBI NDIHMËN JURIDIKE MIQËSORE PËR FËMIJËT

1. Kompetenca gjatë dhënies së ndihmës juridike për fëmijët
2. Veprimi në interesin më të lartë të fëmijës
3. Pjesëmarrja efektive
4. Ndërtimi i marrëdhënies
5. Komunikimi i ndjeshëm ndaj fëmijëve
6. Dhënia e informacionit të besueshëm dhe të përshtatshëm
7. Pjesëmarrja efektive në proceset formale
8. Bashkëpunimi me pjesëtarë të familjes dhe të rritur të tjerë mbështetës
9. Jeta private dhe konfidencialiteti
10. Mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi
11. Mbajtja e fëmijëve të sigurt
12. Bashkëpunimi me të tjerët

# UDHËZIMI 1: Kompetenca gjatë dhënies së ndihmës juridike për fëmijët

**Profesionistët ligjorë, të cilët iu japin fëmijëve ndihmë juridike, duhet të kenë njohuri mbi legjislacionin material dhe procedural të vendit përkatës, mbi të drejtat e fëmijëve, fazat e zhvillimit të fëmijës dhe mënyrën se si duhet të komunikojnë me fëmijët. Aftësitë e tyre duhet të përditësohen dhe të rifreskohen nëpërmjet trajnimeve të rregullta për zhvillimin profesional.**

Ofrimi i ndihmës juridike kompetente dhe efektive për fëmijët përfshin më tepër se sa thjesht njohjen e legjislacionit dhe procedurave kombëtare; ai kërkon gjithashtu dhe një nivel të lartë motivimi, përkushtimi, aftësie, trajnimi dhe njohurish. Profesionistët ligjorë duhet:

- të njohin të drejtat e fëmijëve dhe të dinë si mund të vihen ato në jetë duke përfshirë, të paktën, dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore për Fëmijët;
- të kuptojnë mirë procedurat ligjore civile, penale dhe administrative për fëmijët, përfshirë dhe masat e ndryshme që mund të merren, si shmangia apo proceset e drejtësisë restauruese;
- të dinë kur dhe si të kërkojnë këshillë dhe mbështetje të specializuar nga profesionistët e duhur, si psikologët dhe punonjësit socialë;
- të kenë njohuri profesionale rreth fazave të ndryshme të zhvillimit fizik, njohës, emocional dhe shoqëror të fëmijëve;
- të jenë të vetëdijshëm mbi mënyrat e komunikimit të fëmijëve dhe se si ato ndryshojnë përgjatë fëmijërisë;
- të jenë në gjendje të komunikojnë në mënyrë të efektshme me fëmijët;
- të jenë të ndërgjegjshëm dhe të ndjeshëm kur merren me fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, për të shmangur viktimizimin dytësor;
- të kenë kaluar rivlerësimet e nevojshme, si: të kenë bërë deklarinimin e gjendjes së tyre gjyqësore apo historikut të tyre penal; dhe
- të angazhohen me përgjegjësi për të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme dhe të jenë të përditësuar me zhvillimet e ligjit dhe praktikave që kanë të bëjnë me fëmijët.

Vetëm një pjesë e vogël e juridiksioneve në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, apo dhe botërisht, përmbajnë detyrime ligjore për profesionistët, të cilët iu japin asistencë juridike fëmijëve, që të specializohen dhe trajnohen. Krahas kësaj, nuk janë të shumta juridiksionet ku puna e profesionistëve ligjorë monitorohet dhe kontrollohet sistematikisht për të garantuar cilësinë e shërbimit apo që kanë kode specifike të sjelljes për sa i takon punës me fëmijët. Profesionistët ligjorë duhet të nxitin hartimin e kodeve dhe rregulloreve të tilla, si dhe të rritin mundësitë e tyre për trajnim dhe specializim duke punuar ngushtësisht me Dhomat e Avokatisë ose organe të tjera të posaçme.

# UDHËZIMI 2: Veprimi në interesin më të lartë të fëmijës

**Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore në të gjitha veprimet që ndërmerren kur fëmijët janë në kontakt me ligjin. Profesionistët ligjorë duhet të kenë parasysh këtë detyrim dhe duhet t'i përmbahen atij nëpërmjet vlerësimit dhe të vepruarit në interesin më të lartë të fëmijëve, të cilët janë klientë të tyre.**

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të drejtojë të gjitha aspektet e trajtimit të klientit fëmijë. Megjithatë ky parim është mjaft i spikatur në proceset familjare dhe civile, është e rëndësishme që të trajtohet si konsideratë parësore dhe në proceset penale. Parimi duhet të udhëheqë:

- mënyrën se si një profesionist ligjor ndërton marrëdhënien me një fëmijë: për shembull, ai ose ajo duhet t'i kushtojë kohë dhe burime ngritjes së një marrëdhënieje të besuar me fëmijën, me qëllim që të kuptojë se çfarë është në interesin më të lartë të fëmijës;
- mënyrën se si profesionisti ligjor zhvillon dhe përshtat strategjitë për çështjen, me qëllim arritjen e rezultatit më të mirë ligjor: për shembull, profesionisti mund të vendosë që, më tepër në interesin më të lartë të fëmijës është të pranojë fajin dhe të negociojë me autoritetet, të heshtë gjatë marrjes në pyetje nga policia apo të luftojë për masa të shmangies ose procese të drejtësisë restauruese, si alternativa përkundrejt ndjekjes penale;
- mënyrën e ndërveprimit me aktorë të tjerë kyçë, si policia apo gjyqtarët, me qëllim që të sigurojë që interesi më i lartë i fëmijës të jetë konsideratë parësore përgjatë fazave të ndryshme të procesit: për shembull, një profesionist ligjor mund të vendosë që t'i mëshojë faktit që vonesat gjatë çështjes të jenë sa më të pakta; që mjedisi në sallën gjyqësore të jetë i përshtatur për fëmijën; apo të kufizojë nevojën për marrjen në pyetje të fëmijës në mënyrë të përsëritur, duke ua dhënë vetë informacionin profesionistëve të tjerë (me pëlqimin e fëmijës); si dhe
- mënyrën e advokimit se si interesi më i lartë i fëmijës duhet të interpretohet nga gjykata apo tribunali. Në shumë juridiksione, gjykata ka përgjegjësinë për të vepruar në interesin më të lartë të fëmijës (për shembull në procese të çështjeve familjare që kanë të bëjnë me lënien e fëmijës për rritje dhe edukim njërit prind). Mund të ekzistojë një kuadër i qartë ligjor për t'u ndjekur, i cili përcakton kriteret e posaçme që duhen marrë parasysh kur vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës. Profesionistët ligjorë mund t'i paraqesin gjykatës ose tribunalit argumente bindëse lidhur me interesin më të lartë të fëmijës.

Kur vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës në faza të ndryshme të proceseve, profesionistët ligjorë duhet të marrin parasysh pikëpamjet e fëmijës dhe t'iu japin peshën e duhur, me qëllim që fëmija të luajë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e asaj çfarë është në interesin e tij/saj më të lartë. Është shumë e rëndësishme që përfaqësuesi ligjor i fëmijës të mos hedhë poshtë pikëpamjet e tij/saj nëse nuk është dakord me atë që mendon fëmija, pasi roli i përfaqësuesit është marrja e pëlqimit të informuar të fëmijës për atë strategji që është më e mira për t'u përdorur.

Nuk ekziston një 'listë' përfundimtare që duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës. Një listë e tillë do të ishte e pamundur që të krijohet, pasi rrethanat individuale të fëmijëve janë të ndryshme në çdo çështje. Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës është një proces i cili duhet rishikuar dhe përshtatur vazhdimisht me ndryshimin e rrethanave ose pikëpamjeve të fëmijës. Megjithatë, disa nga kriteret që duhen marrë në konsideratë kur vlerësohet se cila është mënyra më e mirë për të vepruar në interesin më të lartë të fëmijës përfshijnë:

mirëqenien e përgjithshme të fëmijës; gjendjen fizike, mendore, shpirtërore, morale, psikologjike dhe shoqërore të tij/saj; dhe nevojën e fëmijës për arsim dhe një mjedis të shëndetshëm e të sigurt. Kur vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës, duhen marrë parasysh një sërë qasjesh të ndryshme, si:

- këndvështrimi gjithëpërfshirës mbi zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës, bazuar në marrëdhënien e mirë me të dhe mbi njohjen e rrethanave dhe jetës së fëmijës përtej problemeve ligjore të çështjes. Shpeshherë, profesionistët ligjorë vijnë nga familje dhe rrethana shumë të ndryshme nga ato të klientëve të tyre fëmijë. Ndaj, ata duhet ta mbajnë parasysh këtë gjë dhe të përpiqen që ta kuptojnë situatën në të cilën fëmija po rritet;
- të këshillohen me të tjerë, si: punonjës socialë, prindër, mësues, mjekë dhe psikologë, për të kuptuar më mirë nevojat e fëmijës;
- të kenë një kuptim të gjerë e të përgjithshëm mbi problemet e zakonshme që prekin fëmijët, si ndikimi që shkakton tek ata fakti që mund të jenë dëshmitarë apo të kenë përjetuar dhunë, sëmundjet mendore, varësia nga droga ose alkooli dhe shpërbërja e familjes, me qëllim që të kuptohen më të mirë rrethanat e çështjeve individuale;
- të marrin parasysh konsideratat afatgjata dhe afatshkurtra për të ardhmen e fëmijës: çfarë është në interesin e menjëhershëm më të lartë të fëmijës duhet të balancohet me interesin më të lartë të fëmijës pas pesë, dhjetë apo më shumë vitesh; dhe
- të baraspeshojnë rreziqet e një rruge të caktuar veprimi, që mendohet se mund të jetë në interesin më të lartë të fëmijës, me faktorët mbrojtës të jetës së tij/saj, të cilët mund të ndihmojnë në lehtësimin e rreziqeve.

### Si vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës nga gjykatat në Angli dhe Uells

“Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës përfshin një vlerësim të përgjithshëm të mirëqenies, duke marrë parasysh, sipas rastit, një gamë të gjerë konsideratash etike, shoqërore, morale, fetare, kulturore, emocionale dhe të mirëqenies. Gjithçka që është në dobi të mirëqenies dhe lumturisë së fëmijës, apo që ka të bëjë me zhvillimin dhe jetën e tij/saj në të tashmen dhe të ardhmen si qenie njerëzore, duke përfshirë mjedisin familjar, arsimor dhe shoqëror të fëmijës, si dhe komunitetin shoqëror, kulturor, etnik dhe fetar, mund të jenë me rëndësi dhe duhen marrë në konsideratë, sipas rastit. Gjyqtari duhet të përdorë një qasje gjithëpërfshirëse”.

*Gjyqtari Munby, Re G (Fëmijët) [2012] GJAAU (EWCA) Civ 1233*



# UDHËZIMI 3: Pjesëmarrja efektive

**Përgjatë procesit gjyqësor, profesionistët ligjorë duhet të bëjnë të mundur që pikëpamjet dhe zëri i fëmijës të dëgohen dhe t’iu jepet rëndësia e duhur.**

Neni 12 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës përcakton qartë se fëmijët që janë të aftë të krijojnë pikëpamjet e tyre, kanë të drejtë të marrin pjesë dhe t’i shprehin lirisht këto pikëpamje në të gjitha proceset gjyqësore dhe administrative që kanë të bëjnë me ta. Pikëpamjeve të fëmijës duhet t’u jepet pesha e duhur, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. Kjo është një e drejtë thelbësore në kontekstin e proceseve gjyqësore, ku autoritetet shpesh prirën të marrin vendime të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm dhe afatgjatë në jetët e fëmijëve, pa dëgjuar më parë pikëpamjet e vetë atyre.

Pjesëmarrja aktive e fëmijëve në çështjet e tyre mund të jetë shumë e dobishme për ta dhe për procesin ligjor. Marrja në konsideratë e opinioneve të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë, mund t’i ndihmojë ata që ta marrin veten nga ngjarja e përjetuar, të fitojnë vetëbesim dhe të kuptojnë më mirë aftësitë dhe potencialin e tyre. E drejta për të marrë pjesë mund t’i ndihmojë fëmijët që shkelin ligjin për të zhvilluar ndjenjën e përgjegjësisë dhe mund të ndihmojë në rehabilitimin e tyre dhe riintegrimin në komunitet. Shkëmbimi i pikëpamjeve midis profesionistit ligjor dhe fëmijës klient mund ta ndihmojë avokatin/en të kuptojë më mirë interesin më të lartë të fëmijës si dhe të shërbejë si bazë për zgjidhje inovatore dhe kreative për problemet ligjore. Pjesëmarrja duhet të jetë gjithmonë vullnetare dhe fëmijët duhet të kenë të drejtën të mos marrin pjesë nëse nuk dëshirojnë.

**“Të gjitha proceset ku fëmija apo fëmijët dëgohen dhe marrin pjesë, duhet të jenë: transparente dhe informuese, vullnetare, të respektueshme, të vlefshme, miqësore me fëmijët, gjithëpërfshirëse, të mbështetura nga trajnimet, të sigurtat e të ndjeshme ndaj rrezikut, dhe të përgjegjshme”.**

*Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Koment i Përgjithshëm 12*

Profesionistët ligjorë luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e të drejtës së fëmijëve për pjesëmarrje në sistemet e drejtësisë. Më poshtë janë paraqitur disa prej sugjerimeve për zbatimin e kësaj:

- asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar aftësia e fëmijëve për të marrë vendime të arsyeshme mbi jetën e tyre;
- duhet të mbështetet aftësia e fëmijëve për të marrë pjesë, nëpërmjet ndërtimit të marrëdhënieve të besueshme dhe komunikimit me ta në mënyrë të ndjeshme (shihni Udhëzimet 4 dhe 5);
- fëmijëve iu duhet dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm për t’iu mundësuar atyre një pjesëmarrje kuptimplotë (shihni Udhëzimin 6);
- që fëmijët të marrin vendime të informuara, avokatët duhet t’u japin shpjegime të qarta mbi pasojat afatgjata dhe afatshkurtra të vendimeve të tyre (shihni Udhëzimin 6);
- duhet bërë përgatitja e duhur e fëmijëve përpara seancave, duke iu dhënë shpjegime si do të jetë seanca, kur dhe ku do të zhvillohet, cilët do të jenë pjesëmarrësit dhe se si do të merren parasysh pikëpamjet e fëmijës;
- avokatët duhet të bëjnë të mundur që interesat, pikëpamjet dhe ndjenjat e fëmijëve t’iu komunikohen qartazi organeve përkatëse, si gjykatave dhe shërbimeve sociale (shihni Udhëzimin 12);

- 
- duhen të ndërmerren veprime pozitive për të siguruar që të gjithë fëmijët të marrin pjesë, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara apo ata që kanë vështirësi në komunikim (shihni Udhëzimin 10);
  - të bëhet e mundur që fëmijët që dëgjojnë gjatë proceseve formale të jenë në gjendje të shprehen lirisht, dhe që këto procese të zhvillohen në mënyrë miqësore me fëmijët. Për shembull, gjatë marrjes në pyetje nga policia, një profesionist ligjor duhet të ndërhyjë nëse pyetjet janë të papërshtatshme apo armiqësore (shihni Udhëzimin 7) dhe t'ua bëjnë me dije dhe profesionistëve të tjerë ligjorë të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje; dhe
  - të informojnë fëmijën se si gjykata apo tribunali morën parasysh pikëpamjet e tij/saj në marrjen e vendimit. Shpesh, ky informim i fëmijës anashkalohet, por ai është pjesë e rëndësishme e procesit dhe thekson faktin që pikëpamjet e fëmijës nuk dëgjojnë vetëm sa për t'iu përmbajtur procedurave, por ato merren vërtet seriozisht.

# UDHËZIMI 4: Ndërtimi i marrëdhënies

## **Një profesionist ligjor duhet të ndërtojë një marrëdhënie besimi dhe mbështetjeje me klientin fëmijë.**

Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënies me fëmijën është themeli i një përfaqësimi dhe mbështetjeje cilësore. Me aq sa është e mundur, i njëjti profesionist ligjor duhet të komunikojë me fëmijën që prej fillimit të çështjes e deri në përfundim të saj, dhe gjithashtu duhet të mundësohet një profesionist ligjor i një gjinie të caktuar nëse fëmija shpreh dëshirën për këtë.

Profesionistët ligjorë duhet të shpjegojnë që në fillim se roli i tyre është i ndryshëm nga roli i të rriturve të tjerë që janë pjesë e sistemit ligjor, si gjykatësit apo prokurorët, dhe se detyra e tyre është që t'i ofrojnë fëmijës përfaqësimin dhe mbështetjen më të mirë të mundshme. Me qëllim krijimin e marrëdhënies së besimit me fëmijën, pritshmëritë duhet të menaxhohen në mënyrë të kujdesshme përgjatë procesit, në mënyrë që profesionisti ligjor të mos premtojë diçka që mund të mos jetë e realizueshme. Në varësi të rrethanave të çështjes, krijimi i besimit mund të përfshijë dhe punën e ngushtë me familjen e fëmijës apo me të rritur të tjerë mbështetës (shihni Udhëzimin 8).

Parapëlqehet që avokati/ja të takohet personalisht me fëmijën. Kjo i mundëson profesionistit që t'i shpjegojë fëmijës se çfarë po ndodh, çfarë mundësish ka në dispozicion dhe se çfarë do të ndodhë më tej, si dhe mund t'iu përgjigjet pyetjeve që fëmija mund të ketë. Problemet në komunikim mund të tejkalohen më lehtë kur avokati/ja e takon vetë fëmijën. Kështu, dhe profesionisti arrin të krijojë një ide rreth fëmijës dhe të vlerësojë rrethanat e tij/saj. Shpesh, kjo gjë sjell një kuptim më të mirë të çështjes dhe gjetjen e zgjidhjeve krijuese në interes të fëmijës. Edhe në rastet kur fondet janë të kufizuara, profesionisti duhet të përpiqet që të takohet personalisht me fëmijën aq shpesh sa është e nevojshme për ta përgatitur atë plotësisht, gjithmonë duke mbajtur parasysh që fëmija duhet të shkojë edhe në shkollë apo të ketë detyrime familjare për të përmbushur.

Krahas takimit personal, mund të përdoren dhe rrugë të tjera komunikimi për të mbajtur marrëdhënie me fëmijën klient. Profesionisti mund t'i dërgojë fëmijës përditësime të rregullta nëpërmjet postës, telefonit, mesazheve telefonike, medias sociale ose e-mail. Është e rëndësishme që avokati/ja të sigurohet se këto mënyra komunikimi janë të sigurta, të aksesueshme, konfidenciale dhe të besueshme për përdorim nga fëmija. Gjithashtu, duhet që t'i shpjegoni fëmijës se disa mënyra komunikimi mund të jenë më konfidenciale se të tjerat, për shembull: policia mund të arrijë të analizojë mesazhet nëse telefoni konfiskohet gjatë hetimit.

Takimi i parë me fëmijën është veçanërisht i rëndësishëm për të lënë një përshtypjeje të mirë dhe për ta bërë fëmijën të ndihet i sigurt dhe i mbështetur. Sikundër takimi me një klient të rritur, takimi i parë me fëmijën kërkon përgatitje të kujdesshme duke lexuar të gjitha materialet e posaçme, duke njohur ligjin e zbatueshëm si dhe rrethanat e fëmijës. Mundësisht, takimi(et) duhet të zhvillohen në një mjedis të rehatshëm dhe të përshtatshëm për fëmijën, që ofron mundësinë më të mirë që fëmija të ndihet i sigurt dhe të jetë në gjendje të flasë lirish: ndonjëherë mjedisi më i përshtatshëm është vetë banesa e fëmijës. Nëse takimi i parë zhvillohet në zyrë, ka disa mënyra për ta bërë atë miqësore për fëmijën, si: trajnimi i stafit që ta mirëpresë fëmijën dhe vënia e disa lodrave dhe librave për mosha të ndryshme në dhomën e pritjes. Fëmijët nuk duhen lënë të presin për një kohë të gjatë dhe dhoma e takimit duhet të organizohet në mënyrë jo-ballafaquese, ku profesionisti ligjor të mos jetë i ulur pas një tavoline.

Nëse takimi zhvillohet në një rajon policie, gjykatë apo në një mjedis dënimi ose imigracioni, duhet mbajtur parasysh stresi që këto mjedise i shkaktajnë fëmijës dhe cënueshmëria e tij/saj. Shpesh, profesionistët ligjorë janë mësuar me punën në këto mjedise dhe mund të harrojnë se sa të huaja dhe të frikshme janë ato për fëmijët. Në rrethana të tilla duhet të shkoni në orar (pasi pritjet e gjata mund të konsiderohen si mungesë përkushtimi), të takoheni privatisht (mundësisht në një dhomë të veçantë, pa praninë e policëve apo oficerëve të paraburgimit) dhe të përdorni komunikim të përshtatshëm.

Pavarësisht mjedisit ku zhvillohet takimi, përpara se të filloni me diskutimet e çështjeve ligjore, thejeni akullin dhe nisni me krijimin e besimit të fëmija duke e pyetur se si është dhe duke bërë pyetje të tjera joformale që nuk kanë të bëjnë me çështjen. I tregoni fëmijës se jeni aty për ta ndihmuar dhe që jeni në anën e tij/saj. Bëni pushime nëse nevojiten dhe kuptoni që fëmija mund të jetë në tension apo ka vështirësi të përqendrohet për një kohë të gjatë.

Logjistika është gjithashtu e rëndësishme për krijimin e një marrëdhënieje dhe garantimin e mbarëvajtjes së procesit. Është e rëndësishme që të merrni vesh se si do të udhëtojë fëmija drejt gjykatës apo me çfarë do të vijë në takimin e radhës, si do të mbulojë shpenzimet e transportit dhe se cila është metoda më e mirë e komunikimit për të njoftuar ndryshimet e çasteve të fundit.

Së fundmi, nëse marrëdhënia me fëmijën bëhet jofunksionale dhe ai ose ajo kërkon të ndryshojë avokat, atëherë respektoni të drejtën e fëmijës për të zgjedhur avokatin e vet, por duke i shpjeguar vështirësitë që mund të vijnë prej kësaj.

**“Të punosh me fëmijët është më shumë se sa të jesh një avokat profesionist, sepse ndonjëherë na duhet të jemi dhe psikologë për të kuptuar zërin e fëmijëve”.**

*Avokat/e në Shqipëri*

# UDHËZIMI 5: Komunikimi i ndjeshëm ndaj fëmijëve

**Fëmijët nuk mund të kenë pjesëmarrje kuptimplotë në procese, për sa kohë profesionistët ligjorë nuk komunikojnë me ta në mënyrë të ndjeshme ndaj fëmijëve.**

Komunikimi është baza e ndihmës juridike cilësore. Komunikimi efektiv me fëmijën kërkon që profesionisti të përdorë një qasje të ndryshme nga ajo që përdoret ndaj të rriturve. Ata duhet të mbajnë parasysh moshën, gjininë, fenë, aftësinë e kufizuar fizike dhe/ose mendore, nivelin e vetëbesimit dhe fazën e zhvillimit, gjendjen emocionale, arsimin dhe kulturën e fëmijës. Gjithashtu, ata duhet të mbajnë parasysh faktin që zhvillimi i fëmijës është dinamik dhe ndikohet thellësisht nga përvojat e tyre dhe marrëdhëniet me personat e rëndësishëm për ta, si dhe perceptimet dhe reagimet që ata kanë ndaj këtyre përvojave dhe marrëdhënieve.

Për të arritur në vlerësime të aftësisë së fëmijëve, është e rëndësishme të mos bëni supozime të bazuara në moshën e tyre, por të integroni njohuritë tuaja mbi zhvillimin e fëmijës me informacionet që keni për fëmijën para jush. Është e rëndësishme që mënyra se si profesionisti komunikon me fëmijën, të mos përforcojë asnjë aspekt të përvojave diskriminuese apo abuzive që fëmija ka përjetuar.

Komunikimi i mirë ka disa elemente, të cilat përfshijnë: dhënien e informacionit të nevojshëm; të dëgjuarit aktiv dhe diskutimin e zgjedhjeve të ndryshme pa paragjykim, në mënyrë që fëmija të ketë kontroll mbi vendimmarrjen; t'i jepni mundësinë fëmijës të marrë persona mbështetës gjatë këshillimeve (për shembull, prindin/kujdestarin, një profesionist të besuar, motrën, vëllanë ose një shok); të jeni të duruar dhe mirëkuptues; të flisni qartazi dhe në mënyrë të saktë, duke përdorur terma që fëmija mund t'i kuptojë:

- përdorni fjalor të thjeshtë dhe të përshtatshëm për moshën dhe rrethanat e fëmijës;
- përdorni fjalë të shkurtra dhe me përdorim të shpeshtë;
- përdorni fjali të shkurtra;
- drejtojuni fëmijëve pyetje të qarta; dhe
- shmangni gjuhën profesionale dhe zhargonin juridik.

**“Secili fëmijë po përjeton ndryshime të mëdha shoqërore dhe fizike; përpiquni ta vendosni veten në vendin e tyre kur e shihni që nuk jeni dakord me ta apo po humbisni durimin”.**

*Avokat/e në Bosnje*

Fëmijët nuk e përdorin apo kuptojnë gjuhën njësoj si të rriturit, dhe fëmijët e së njëjtës moshë mund të kenë aftësi tepër të ndryshme komunikimi. Fëmijët në moshë të vogël mund të kenë probleme me të kuptuarin e gjuhës abstrakte dhe të paqartë, dhe mund të kenë vështirësi në konceptimin e kohës, hapësirës dhe matjeve, si dhe në formulimin e ndodhive të qarta. Gjithashtu, fëmijët parashkollorë mund të kenë vështirësi në kuptimin e perspektivave të të tjerëve, ndaj mund të supozojnë që të tjerët mendojnë dhe ndihen njësoj si ta. Edhe fëmijët në moshë më të madhe mund t'i kenë këto karakteristika zhvillimi dhe mund të jenë edhe më të ndjeshëm ndaj trajtimit si inferiorë.

Qëndrimi i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, siç deklarohet në Komentin e Përgjithshëm Nr. 12 mbi të Drejtën për t'u Dëgjuar është se "fëmija është në gjendje të formojë pikëpamje që në moshë shumë të vogël, edhe nëse ai ose ajo mund të mos jetë në gjendje t'i shprehë ato në mënyrë verbale". Profesionistët ligjorë duhet t'iu përshtaten mënyrave të ndryshme me anë të së cilave shprehen fëmijët e vegjël, duke përfshirë lojën, sjelljen, ndërveprimin me kujdestarët dhe gjuhën e trupit.

### **Komunikimet e ndjeshme ndaj fëmijëve - disa nga pyetjet për t'u marrë në konsideratë**

- A jam duke i parë problemet ligjore të çështjes nga këndvështrimi i fëmijës që është klienti im, në vend që t'i shoh ato nga këndvështrimi i një të rrituri?
- A arrin fëmija të kuptojë sa më shumë që mundet rreth çështjes/situatës: a ka gjëra të tjera për t'u shpjeguar, apo që mund të shpjegohen në mënyrë më të mirë?
- Nëse po e trajtoj klientin fëmijë ndryshe nga si do trajtoja një të rritur, a është kjo në interesin e tij/saj më të lartë?
- A mos jam duke u ndikuar më shumë se sa duhet nga opinionet e të rriturve të përfshirë në këtë çështje?

Fëmijët mund të kenë përqendrim të ulët dhe fjalor e aftësi të kufizuara për të lidhur ngjarjet në rend kronologjik. Ata mund të kenë frikë për pasojat që ata dhe familjet e tyre mund të vuajnë nëse japin të tilla informacione, dhe përjetojnë ndjenja të theksuara turpi, stresi dhe faji. Shumë fëmijë dëshirojnë të kënaqin të rriturit me autoritet, përfshirë edhe profesionistët ligjorë, duke thënë gjëra që mendojnë se janë ato çfarë priten prej tyre, ose mund të jenë edukuar të dëgjojnë të rriturit, por jo të flasin me ta. Ata thjesht mund të mos kuptojnë kompleksitetin e çështjeve ligjore dhe mund të ngatërrohen nga terminologjia.

Është praktikë e mirë të strukturoni me kujdes takimin me një fëmijë klient. Gjatë pjesës fillestare profesionisti ligjor duhet të prezantojë veten dhe ta bëjë fëmijën të ndihet i/e qetë, duke shpjeguar qëllimin e intervistës, kush do të jetë i pranishëm, sa do të zgjasë dhe çfarë do të ndodhë më pas. Profesionisti gjithashtu duhet t'i shpjegojë si do të regjistrohet intervista dhe si do të përdoret informacioni që fëmija jep. Është e rëndësishme të kuptojmë se mund të duhet pak kohë përpara se fëmija të jetë mjaftueshëm komod për të folur, veçanërisht kur fëmija po rikujton ngjarje që janë traumatike ose përfshijnë detaje intime.

Fëmijët mund të shprehen më mirë nëse u jepet liria ta bëjnë sipas mënyrës së tyre dhe në momentin që ata duan. E rëndësishme është të jeni të duruar, të respektoni heshtjen e tyre dhe të mos nxisni fëmijët ose të mos vini fjalë në gojën e tyre. Fëmijëve u duhet thënë se është e pranueshme të thonë, "nuk e di" kur nuk e dinë përgjigjen e një pyetjeje ose që nuk e mbajnë mend dhe që mund të pyesin nëse nuk e kuptojnë natyrën e një pyetjeje. Duhet t'i theksohet që edhe pse nuk ka përgjigje të sakta ose të gabuara të pyetjeve, është e rëndësishme të japin të dhëna të vërteta dhe të jenë sa më të saktë të jetë e mundur. Ata duhet të binden që është e pranueshme të përdorin fjalë "të pasjellshme" kur është e nevojshme.

Përmbliidhni çfarë ju thotë fëmija. Kjo është një aftësi kyçe që do t'i japë strukturë intervistës. Avokati mund ta përdorë këtë mjet për të konfirmuar që çështja është kuptuar, duke bërë bashkë aspekte të ndryshme të ngritura nga fëmija dhe më pas ose të eksplorojë më tej mbi ato çfarë ka thënë deri në atë moment fëmija ose ta zhvendosë intervistën në një temë të re. Kur kontrolloni nëse fëmija e kupton informacionin e dhënë, është më mirë të bëni pyetje specifike si "në cilën datë është seanca tjetër" në vend që të pyesni "a e kuptove?". Nëse një nga mënyrat e të shpjeguarit nuk funksionon, provoni një mënyrë tjetër. Nëse komunikimi është tepër i vështirë, atëherë mund të jetë e nevojshme të punoni me punonjës socialë ose profesionistë të tjerë për të lehtësuar komunikimin.

Kur është e nevojshme të bëni pyetje për të qartësuar ngjarjet ose për të kërkuar më tepër informacion, ato duhet të jenë sa më të hapura të jetë e mundur. Pyetjet që përdorin frazën "më thuaj" ose fjalën "përshkruaj" janë shembuj të dobishëm të kësaj lloji pyetje, si për shembull: "The se ishte në autobus sot në mëngjes kur ndodhi diçka: më trego të gjitha ato që të kujtohen". Asnjëherë nuk duhen bërë pyetje të drejtuara ose sugjeruese që e shtyjnë fëmijën drejt një përgjigjeje të caktuar. Përsëritja e pyetjeve duhet të shmanget pasi mund t'i sinjalizojë fëmijës se përgjigjet e mëparshme që dha ishin të papranueshme ose të "gabuar".

Mbyllja e takimit siç duhet është thelbësore. Fëmijët duhet të pyeten nëse ka diçka tjetër që duan të shtojnë apo që dëshirojnë t'ju thonë, ose nëse kanë pyetje për të bërë. Gjithashtu është e rëndësishme t'i përsërisni si do të përdoret informacioni dhe të menaxhoni pritshmëritë e fëmijës për çka mund të ndodhë në të ardhmen. Fëmija duhet falënderuar dhe i duhen bërë të ditura shërbimet mbështetëse të disponueshme për të.

Profesionistët ligjorë duhet të kenë parasysh se fëmija mund të mos kuptojë terminologjinë ligjore dhe se çështjet ligjore ku janë përfshirë mund të jenë të ndërlikuara. Terminologjia e përdorur çdo ditë nga profesionistët, si "punonjës social", "gjykatë", "seancë dëgjimore", "apel" dhe të tjera si këto, mund të jenë të panjohura për një fëmijë që nuk ka përjetuar një proces gjyqësor kurrë më parë; për shembull, edhe pse prindërit e fëmijës janë ndarë, fëmija mund të mos e dijë saktësisht se çfarë do të thotë "divorc/zgjidhje martesë". Terminologji komplekse, të tilla, si: "prezumimi i pafajësisë" mund të jenë edhe më problematike. Krijimi i një fjalorthi me terma kyçë miqësorë me fëmijët që ata dhe familjet e tyre mund ta marrin me vete mund të jetë e dobishme. Ndihmë pamore, si: diagramet, grafikët dhe fotot, gjithashtu mund të jenë të dobishme për të përçuar informacion.

**"Ne duhet t'u shfaqim fëmijëve interesin tonë jo vetëm për statusin e tyre ligjor, por edhe për mirëqenien e tyre psiko-sociale."**

*Avokat/e në Greqi*

Mendoni për komunikimin jo-verbal. Përpiquni të jeni sa më të çlirët dhe të kuptoni sinjalet nga klienti juaj fëmijë. Nëse ai ose ajo nuk ndihet i lirshëm/e lirshme t'ju shohë në sy, atëherë mos e detyroni. Ndonjëherë ngurrimi për të dhënë udhëzime vjen nga nervozizmi ose frika ose një ndjesi e tepërt ankthi gjatë kohës që flitet për kujtime të dhimbshme. Në situata të tilla, profesionisti ligjor duhet të jetë proaktiv, ta bëjë fëmijën të ndihet i lirshëm dhe i sigurtë dhe ku nevojitet të ndjekë një qasje tjetër ndaj udhëzimeve të bashkëbisedimit. Nëse është e nevojshme, profesionistët mund të kërkojnë ndihmën e të tjerëve për të përcaktuar dëshirat dhe udhëzimet e fëmijës.

### **Listë kontrolli për komunikimin.**

- Përdorni terma konkretë dhe fjali të thjeshta.
- Bëni pyetje të hapura, dhe përfshini sa më pak informacion të jetë e mundur në bisedë, për t'u siguruar që tregimi i fëmijës të mbetet autentik ('Më trego rreth asaj që ka ndodhur...').
- Kontrolloni nëse fëmija e ka kuptuar saktësisht se çfarë i është thënë.
- Inkurajoni fëmijën të tregojë kur ai/ajo nuk kupton diçka.
- Nëse fëmija shfaq emocione gjatë bisedës (si shpërthime në lot apo nervozizëm) atëherë kuptojini dhe pranojini këto ndjenja ("E shoh që kjo të mërzit.") dhe sigurojeni fëmijën që nuk përbën problem që ndihet ashtu dhe që i shfaq ndjenjat. Mund të ndryshoni qendrën e bisedës në diçka më pak stresuese derisa fëmija të jetë gati t'i rikthehet; kjo mund të ndodhë në të njëjtën ditë ose në një kohë tjetër, varet nga intensiteti i emocioneve.
- Bëni pyetje konkrete që fillojnë me kush/çfarë/ku.
- Mos supozoni se një fjalë ka të njëjtin kuptim si për të rriturit ashtu edhe për fëmijën.
- Tregohuni të qartë kur formuloni pyetjet dhe përsëritini sa herë të jetë e mundur.
- Pyeteni fëmijën për ngjarjet një e nga një.
- Reagoni pozitivisht ndaj përgjigjeve të fëmijës: inkurajimi dhe lavdërimi mund të nxitin sinqeritetin.
- Uluni në të njëjtin nivel me fëmijën.
- Fëmijëve më të rritur referojuni si të rinj, jo si fëmijë dhe theksoni vlerën dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre (nëse kjo është në interesin e tyre më të lartë).
- Inkurajoni fëmijën të bëjë pyetjet që ai/ajo mund të ketë, përpara se ta përfundoni bisedën.
- Në fund të bisedës falënderojeni fëmijën që mori pjesë në këtë procedurë.



# UDHËZIMI 6: Dhënia e informacionit të besueshëm dhe të përshtatshëm

**Profesionistët ligjorë duhet t'u ofrojnë fëmijëve informacion të besueshëm dhe të përshtatshëm në mënyrë që ata të marrin pjesë realisht në proceset e vendimmarrjes.**

Fëmijët nuk mund të marrin pjesë në mënyrë kuptimplotë në procese ligjore në rast se nuk kanë kuptuar qartësisht faktet dhe nuk janë të vetëdijshëm për pasojat e mundshme të vendimeve që marrin. Informacioni i besueshëm dhe i përshtatshëm duhet t'u ofrohet drejtpërdrejt fëmijëve në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në mënyrë që të jenë të informuar kur marrin vendime, edhe pse ata nuk janë gjithmonë vendimmarrësit kryesorë.

**“Është e rëndësishme të mos nënvlerësohet aftësia e fëmijës për të kuptuar situatën dhe shpjegimet e këshillat tuaja.”**

*Avokat/e në Serbi*

Informacioni i ofruar duhet të mbulojë detajet e çështjes së tyre specifike, si dhe mund të përfshijë:

- Rolin e profesionistit ligjor dhe çfarë mund (ose nuk mund të bëjë) ai/ajo për ta.
- Cila është rregullsia në komunikim që fëmija duhet të presë nga ekipi ligjor.
- Si funksionon parimi i konfidencialitetit, si do të aplikohet në rastin e fëmijës në raport me prindërit, psikologët, gjykatat, policinë, mësuesit e kështu me radhë dhe rrethanat në të cilat ky parim mund të shkelet.
- Cila është natyra e çështjeve dhe procedurave ligjore dhe përse fëmija është i përfshirë.
- Roli i aktorëve të tjerë në këtë çështje, për shembull i policisë, punonjësve socialë dhe gjyqtarëve.
- Të drejtat specifike të fëmijës në çdo stad të procedurës: për shembull, e drejta për të mos folur, e drejta për të shprehur mendimin e vet, e drejta për t'u mbrojtur dhe e drejta për të marrë një zgjidhje ligjore për shkeljen e të drejtave të tij/saj.
- Vendimet që do të marrin gjykata ose tribunali dhe se çfarë informacioni merret në konsideratë kur merren të tilla vendime, por edhe se si dhe kur merren parasysh pikëpamjet e fëmijës.
- Cilat do të jenë seancat e ardhshme, përse do të zhvillohen ato, sa do të zgjatin dhe nëse kërkohet prania e fëmijës.
- Nëse fëmija do të japë dëshmi gjatë procesit formal dhe avantazhet e disavantazhet e saj (shikoni Udhëzimin 7 më poshtë).
- Çfarë do të thotë të bësh betimin përpara gjykatës.
- Si do të merret në pyetje fëmija përgjatë procesit formal dhe nga kush.
- Një vlerësim i përafërt se sa do të zgjasë i gjithë procesi.
- Çfarë mekanizmash mbështetës ka në dispozicion të fëmijës dhe si t'i aksesojnë ata (mjekësorë, psikologjikë, njësi mbështetëse për viktimat, e kështu me radhë).
- Çfarë masash sigurie dhe mbrojtjeje ka në dispozicion të fëmijës, si strehëza të sigurta dhe urdhra mbrojtjeje.
- Kuptimi dhe pasojat e vendimeve që marrin gjykatat.
- Mënyrat e apelimit ose ankimimit pas vendimit të gjykatës.
- Mënyrat për të kërkuar dëmshpërblim, përfshirë edhe kompensimin financiar.

---

Që në fillim, profesionisti ligjor duhet të menaxhojë pritshmëritë dhe të përgatitë fëmijën për mundësinë që gjykata mund të marrë një vendim që fëmija nuk do ta pëlqejë; për shembull, nëse fëmijës i jepet një dënim me burg, ose një të afërmi i mohohet kontakti me fëmijën.

Informacioni nuk jepet i përgjithshëm por vihet në kontekst, me qëllim që fëmija të kuptojë zgjedhjet/ rrugët që ka në dispozicion dhe të peshojë avantazhet dhe disavantazhet e këtyre mundësive. Ndonjëherë mund të jetë e nevojshme të përsëritet i njëjti informacion disa herë për t'u siguruar që fëmija e ka kuptuar plotësisht. Ndonëse ka mundësi që prindërit gjithashtu të kenë nevojë të marrin informacion për çështjet ligjore të fëmijëve të tyre, komunikimi me prindërit nuk duhet të përdoret si zëvendësues i informimit të fëmijëve. Edhe e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u informuar duhet të vihet në zbatim: për shembull, ata mund të kenë nevojë që informacioni të përsëritet më shpesh, ose të jetë në një format tjetër, si alfabeti braille.

Mund t'ju vijë në ndihmë të mbani fletëpalosje që ofrojnë qartë informacione bazë për sistemin gjyqësor dhe rolin e profesionistit ligjor. Këto fletëpalosje duhet të përshtaten për përdorim nga grupmosha të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme (çështje penale, civile e kështu me radhë). Kur materiale të tilla nuk ekzistojnë, profesionisti ligjor mund të kërkojë krijimin e tyre nga Dhoma e Avokatisë ose ministria përkatëse.

# UDHËZIMI 7: Pjesëmarrja efektive në proceset formale

**Profesionistët ligjorë duhet të sigurohen që fëmijët të marrin pjesë në proceset ligjore formale në mënyrë të sigurt e kuptimplotë dhe me mbështetje kompetente e garanci procedurale.**

Mund të mos jetë gjithmonë në interesin më të lartë të fëmijës të marrë pjesë drejtpërdrejt në procese gjyqësore formale si gjykimi i veprave penale ose seancat për kujdestarinë e fëmijës. Për një fëmijë që ka rënë viktimë e krimit ose është dëshmitar/e i/e tij, kjo mund të sjellë ripërjetimin e ngjarjes traumatike dhe ekspozimin ndaj njerëzve që i kanë lënduar. Për më tepër, kjo mund të ekspozojë një fëmijë të përfshirë në çështje familjare ndaj informacionit të papërshtatshëm dhe të dëmshëm për situatën e tyre familjare. Një profesionist ligjor do të duhet të peshojë avantazhet dhe disavantazhet për secilën çështje kur do të vendosë për mënyrën më të mirë të veprimit. Mund të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Sa e domosdoshme është dëshmia gojore e fëmijës për ta çuar më tej çështjen;
- Cilësia e provave alternative (për shembull nëse dëshmia është regjistruar më parë);
- Moshja, matura, cënueshmëria, aftësia për të kuptuar, kapaciteti dhe kompetencat e fëmijës.
- Periudha kohore që ka kaluar që kur kanë ndodhur ngjarjet në fjalë;
- Mbështetja (ose mungesa e saj) që fëmija ka nga familja ose burime të tjera;
- Dëshirat e vetë fëmijës; dhe
- Pikëpamjet e prindit dhe kujdestarit ligjor.

**“...Do të ishte ekzagjerim të thuash që seksionet familjare në gjykata gjithnjë kërkojnë të dëgjojnë fëmijën në gjykatë për çështje të drejtave të vizitave të një prindi që nuk ka kujdestari, po kjo varet nga rrethanat specifike të secilës çështje, duke pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e fëmijës së përfshirë ”**

*Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Dhoma e Madhe), vendim i datës 8 korrik 2003, Sahin kundër Gjermanisë, Nr. 30943/96, paragrafi 73.*

Ka disa hapa që një profesionist ligjor mund të ndjekë për të mbështetur një fëmijë që do të japë dëshmi personalisht gjatë procesit formal, në mënyrë që fëmija të ndihet më i lehtësuar dhe i çlirët e të japë dëshminë më të mirë të mundshme. Për shembull, fëmija mund të familjarizohet më parë me planin e dhomës së pritjes dhe sallës së gjyqit, pajisjet që mund të përdoren si videoregjistruues, si dhe rolet e ndryshme të personave në sallën e gjyqit dhe ku do të qëndrojnë. Në disa vende, programe të tilla familjarizuese mund të organizohen nga vetë gjykata, por në të tjera duhet të kryhen nga profesionisti ligjor. Nëse një vizitë në sallën e gjyqit nuk është e mundur atëherë do të ishte e dobishme të ofrohej një vizitim i sallës së gjyqit, duke shpjeguar rolet e ndryshme të njerëzve në të.

Një profesionist mund të kërkojë edhe përshtatje të procesit gjyqësor për të ndihmuar fëmijën të ndihet i sigurtë dhe komod. Këto përshtatje mund të përfshijnë:

- Pushime të shpeshta;
- Seancat të mbahen me dyer të mbyllura;

- Dhoma të veçuara pritjeje për fëmijët viktime dhe dëshmitarë;
- Të kërkojë që të hiqen formalitetet për veshjet e seancave gjyqësore (togat dhe kështu me radhë);
- Të kërkojë që fëmija të japë dëshminë nëpërmjet sistemit televiziv me qark të mbyllur kur është e mundur;
- Të sigurojë dakordësinë mbi kufizimet lidhur me natyrën dhe mënyrën e marrjes në pyetje të fëmijës, për shembull të bjerë dakord që të përdoren pyetje të shkurtra e të thjeshta, të mos përdoren teknika agresive të marrjes në pyetje, të vendosen kufizime kohore dhe të përdoren mjete ndihmëse pamore, si: hartat;
- Të kërkojë leje që fëmija të ulet pranë një të rrituri mbështetës dhe që të gjitha palët të ulen në të njëjtin nivel me fëmijën;
- Zhvillimi i seancave dëgjimore të shkurtra që i përshtaten kapacitetit të fëmijës për t'u përqendruar dhe për të ruajtur vëmendjen;
- Kufizimi i ndërprerjeve të pajustificuara ose shpërqendrimeve në seanca, si për shembull njerëz që hyjnë dhe dalin nga salla e gjyqit.
- Kufizimi i numrit të pjesëmarrësve në sallën e gjyqit, duke lënë vetëm personat e përfshirë drejtpërdrejt në proces;
- Shoqërimi i fëmijës nga një person i besuar;
- Të pyesë fëmijën nëse është e përshtatshme që të ketë pjesëtarë të familjes të pranishëm gjatë seancave;
- Të jetë vigjilent ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të tjerë për t'u siguruar që ata ndërveprojnë me fëmijën me respekt dhe në mënyrë të ndjeshme; dhe
- Të sigurohet për praninë e një përkthyesi kur nevojitet.

Është e rëndësishme të mbajmë mend se informacioni që i jepet fëmijës mund të duhet të përsëritet nëse kanë kaluar periudha të gjata kohore ndërmjet seancave dëgjimore dhe seancës përfundimtare dhe se është një përgjegjësi e vazhdueshme e avokatit/es të sigurohet që fëmija është plotësisht i informuar dhe si rrjedhojë i aftë për të marrë pjesë.

**“34. Fëmija nuk mund të dëgjohej në mënyrë efikase nëse ambienti është kërcënues, armiqësor, i pandjeshëm dhe i papërshtatshëm për moshën e tij/saj. Proceset duhet të jenë edhe të aksesueshme, edhe të përshtatshme për fëmijët. Vëmendje e veçantë i duhet dhënë ofrimit dhe përcjelljes së informacionit në mënyrë miqësore me fëmijët, mbështetjes së përshtatshme për vetë-advokimin, stafit të trajnuar siç duhet, projektimit të sallave të gjyqit, veshjes së gjyqtarëve dhe avokatëve dhe dhomave të pritjes të ndara.”**

*Koment i Përgjithshëm Nr. 12, E drejta për t'u Dëgjuar (1 korrik 2019) CRC/C/GC/12*

# UDHËZIMI 8: Bashkëpunimi me pjesëtarë të familjes dhe të rritur të tjerë mbështetës

Një profesionist ligjor duhet të veprojë sipas udhëzimeve të fëmijës dhe në interesin më të lartë të tij/saj, jo në interesin e anëtarëve të familjes.

“Kur bashkëpunoni me anëtarë të familjes, krijoni një atmosferë mikpritëse që nxit përfshirjen e familjes dhe krijimin e besimit...dhe përdorni aftësi efikase komunikimi, si për shembull dëgjimin e vëmendshëm.”

*Avokat/e në Bosnjë*

Në shumicën e rasteve profesionisti ligjor do të zhvillojë një marrëdhënie bashkëpunuese dhe mbështetëse me familjen e klientit fëmijë (ose me të rritur të tjerë mbështetës). Megjithatë, duhet bërë e qartë që në fillim që profesionisti ligjor do të udhëzohet nga fëmija dhe jo nga i rrituri. Kjo do të thotë që profesionisti ligjor nuk do të marrë udhëzime nga një pjesëtar i familjes nëse ato janë në kundërshtim me udhëzimet e fëmijës. Për më tepër, duhet të jetë e qartë që parimi i konfidencialitetit nuk aplikohet në bisedat me anëtarët e familjes. Kur është e nevojshme, prindërve mund t'u rekomandohet të kërkojnë përfaqësuesin e tyre ligjor ose t'u referohen ofruesve të tjerë të shërbimeve.

Edhe me fëmijët më të vegjël, komunikimi duhet të drejtohet te fëmija, ndonëse duhet plotësuar nga komunikimi me të rriturit që i mbështesin ata kur është e përshtatshme. Ndonjëherë mund të jetë e nevojshme t'u kërkojë të rriturve mbështetës të presin jashtë, në mënyrë që fëmija të flasë lirshëm (dhe anasjelltas).

Profesionistët duhet të jenë të vetëdijshëm për dinamikën e pushtetit në marrëdhëniet e rritur-fëmijë, dhe duhet të jenë vigjilent ndaj mundësisë se fëmija mund të jetë duke u manipuluar ose kërcënuar. Është e rëndësishme që interesat e të tjerëve, si: prindërit ose motrat a vëllezërit, që mund të jenë më të artikuluar dhe më të aftë për t'u shprehur, të mos bien në kundërshtim ose mos marrin prioritet mbi interesat e klientit fëmijë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në situata ku prindërit paguajnë tarifën e profesionistit ligjor dhe si rrjedhojë, mund të supozojnë që interesat e tyre iu paraprijnë atyre të fëmijës klient.

Në çështjet kur profesionisti ligjor përfaqëson si fëmijën, dhe të rriturin dhe ka konflikt interesash, atëherë duhet të caktohet një përfaqësues i pavarur për të përfaqësuar pikëpamjet dhe interesat e fëmijës.

Mund të jenë shumë sfiduese rastet kur fëmija merr një vendim që profesionisti ligjor nuk e konsideron në interesin më të lartë të fëmijës, për shembull vendimi për t'u kthyer në shtëpi te një prind abuzues. Në situata të tilla, profesionisti ligjor duhet të përpiqet të bindë fëmijën, siç bën me klientin e rritur, duke u mbështetur në marrëdhënien e besimit me të dhe duke ia identifikuar qartazi zgjedhjet alternative fëmijës. Avokati/ja mund të bashkëpunojë edhe me profesionistë të tjerë për të kuptuar plotësisht nevojat dhe dëshirat e fëmijës dhe rreziqet e lidhura me vendimin.

# UDHËZIMI 9: Jeta private dhe konfidencialiteti

**Profesionistët ligjorë duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës për jetë private gjatë procesit ligjor dhe të sigurohen që të gjitha komunikimet me klientin të mbahen konfidenciale, në pajtim me kodet profesionale të sjelljes.**

E drejta për jetë private është thelbësore: fëmijët viktime dhe dëshmitarë mund të vihen drejtpërdrejt në rrezik dhe të përjetojnë lëndime të rënda emocionale, nëse identiteti i tyre zbulohet dhe fëmijët e pandehur mund të përjetojnë diskriminim dhe stigmatizim nëse vepra që ka kryer bëhet publike. Niveli i rrezikut që vjen nga shkelja e së drejtës për jetë private, mund të mos jetë gjithnjë qartësisht i dukshëm për profesionistët e tjerë të drejtësisë të përfshirë në çështje, si gjyqtarët ose prokurorët. Avokatët luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e kësaj të drejte dhe duhet të bëjnë maksimumin për të siguruar që:

- seancat dëgjimore që përfshijnë fëmijët të mbahen me dyer të mbyllura, përveçse nëse ka arsye të qarta pse është në interesin më të lartë të fëmijës që seancat të jenë publike;
- vendimet të jepen në të tillë mënyrë që identiteti i fëmijës të mos zbulohet;
- dosjet penale të fëmijëve nuk zbulohen pasi ata të arrijnë moshën madhore;
- nëse detajet e një çështjeje ndahen për qëllime mësimore ose me median për shkak të një interesi për publikun, fëmija duhet të japë parapakisht pëlqimin për këtë bërje publike dhe hollësitë e bëra publike nuk duhet të zbulojnë identitetin e fëmijës; dhe
- media të mos zbulojë informacion që mund të çojë në shkelje të jetës private të fëmijës. Ndaj atyre organeve të medias që cenojnë jetën private të fëmijës duhen hapur procese ligjore ose paraqitur ankesa.

Në pjesën më të madhe të vendeve, marrëdhënia ndërmjet klientit dhe avokatit i nënshtrohet rregullave të rrepta për konfidencialitetin dhe kjo vlen sa për fëmijët, po aq edhe për të rriturit. Këto rregulla vlejnë për takimet, korrespondencën, bisedat telefonike dhe format e tjera të komunikimit, si: rrjetet sociale. Kjo është një pjesë thelbësore e ndërtimit të një marrëdhënieje besimi me një klient fëmijë dhe që fëmija të flasë me avokatin hapur dhe lirshëm. Në praktikë kjo do të thotë që një profesionist ligjor duhet:

- të informojë klientin fëmijë se shkëmbimet mes tyre do të jenë konfidenciale;
- të shpjegojë që shkëmbimet midis profesionistëve ligjorë dhe anëtarëve të familjes nuk mbrohen nga të njëjtat rregulla konfidencialiteti;
- të jetë vigjilent për sigurimin e konfidencialitetit në të gjitha format e komunikimit. Për shembull, nëse takohet me një klient në një rajon policie ose në korridoret e një salle gjyqi, të sigurohet që biseda e tyre nuk do të dëgjohet; nëse flet në telefon me një klient fëmijë që është nën arrest, të pyesë fëmijën dhe të sigurohet që nuk po përgjohen; dhe
- të sigurohet që të dhënat personale të fëmijës (për shembull dosja e çështjes) të mbrohen në pajtim me ligjin vendas dhe që mbahen të sigurta dhe nuk mund të aksesohen nga palë të treta, nëse nuk janë në pajtim me interesat më të larta të fëmijës dhe me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo nënkupton që asnjë informacion ose e dhënë personale të mos bëhet e disponueshme ose publikohet, veçanërisht në media, e cila rrezikon të zbulojë (në mënyrë direkte ose jo) identitetin e fëmijës. Kjo përfshin imazhe, përshkrime të hollësishme të fëmijës ose të familjes së fëmijës, emra ose adresa, audio ose regjistrime video dhe kështu me radhë.

---

Mund të ketë rrethana të jashtëzakonshme, të lejuara nga legjislacioni i vendit, kur profesionistët ligjorë duhet t'i zbulojnë informacion konfidencial rreth klientëve të tyre, organit të autorizuar: në shumë juridiksione, rregullat strikte të konfidencialitetit avokat-klient mund të mos merren parasysh nëse ka rrezik që mos-zbulimi të çojë në vdekjen ose lëndimin e një personi, ose nëse ajo çka zbulon fëmija, lidhet me një aktivitet kriminal. Situata të tilla mund të përfshijnë çështje në të cilat fëmija tregon informacione që tregojnë abuzim seksual ose abuzime të tjera fizike të vazhdueshme, por refuzon të lejojë përcjelljen e informacioneve të tilla palëve të treta. Në mënyrë të ngjashme, mund të ketë situata në të cilat i rrituri tregon abuzime të kryera nga ai/ajo vetë ose nga të rritur të tjerë kundrejt një fëmije, por refuzon lejimin e bërjes publike të këtij informacioni.

Kjo mund të jetë një situatë shumë sfiduese pasi parimi i konfidencialitetit qëndron në qendër të ndërtimit të një marrëdhënieje besimi me fëmijën klient. Nuk ka përgjigje të prera, por në të tilla rrethana profesionisti duhet të peshojë pozicionin në ligjin kombëtar se kur është e pranueshme të shkelet konfidencialiteti. Në shumë juridiksione, mbështetja për këto konsiderata të vështira etike mund të jepet nga komisioni i etikës i Dhomës së Avokatisë, i cili mund të ndihmojë në diskutimin e dispozitave kombëtare dhe nëse është në interesin më të lartë të fëmijës të shkelet rregulli i rreptë i konfidencialitetit, për shkak të rrezikut për jetën ose shëndetin fizik e mendor të fëmijës.

# UDHËZIMI 10: Mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi

**Profesionistët ligjorë duhet të sigurohen që fëmijët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të mos diskriminohen për shkak të moshës, gjinisë, etnisë, aftësive të tyre të kufizuara ose gjendjeje tjetër.**

Çdo fëmijë ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, pavarësisht nga raca, etnia, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindja politike ose të tjera, origjina kombëtare, etnike, apo shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër, qoftë e vetë fëmijës, qoftë e prindërve të tij/saj apo të kujdestarit ligjot. Në praktikë kjo do të thotë që profesionistët ligjorë nuk duhet të lejojnë pikëpamjet diskriminuese personale të ndikojnë vendimet e tyre ose cilësinë e shërbimit që ata iu ofrojnë fëmijëve. Ata duhet të sigurohen sa më shumë të jetë e mundur që edhe kolegët e tyre të mos sillen në mënyrë diskriminuese kur punojnë me fëmijët, për shembull: duke vendosur politika anti-diskriminim dhe duke promovuar trajnimin në vendin e punës.

Mund të nevojiten veprime pozitive dhe proaktive për t'u siguruar që fëmija të angazhohet në procesin ligjor. Profesionistët ligjorë duhet të jenë shumë të ndërgjegjshëm për çështje që mund të ndikojnë në aftësinë e fëmijës për të marrë pjesë, përfshirë sëmundjet mendore dhe aftësitë e kufizuara. Në situata të tilla, ata duhet të ndërmarrin hapa të veçanta për t'u siguruar që klientët e tyre fëmijë të marrin pjesë në mënyrë të barabartë. Për shembull, ata mund të kërkojnë që një fëmijë me kombësi të huaj të ketë mbështetjen e një përkthyesi gjatë pyetjes në rajonin policor ose që një fëmijë me sëmundje mendore të ketë mbështetjen e një psikologu, ndërkohë që përgatitet çështja. Profesionistët ligjorë mund të luajnë një rol kyç në ofrimin e mbështetjes shitesë dhe krijimin e vetëbesimit te vajzat që ato të shprehin pikëpamjet dhe mendimet e tyre, në mënyrë që t'u jepet pesha e duhur në vendimmarrje. Fëmijët që kanë qenë viktimë të dhunës seksuale rrezikohen të jenë të diskriminuar dhe duhet t'u jepet e drejta për mbështetje profesionale për t'i ndihmuar në rikuperimin e tyre dhe për të parandaluar një viktimizim të dytë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë më shumë rrezik t'u shkelen të drejtat sesa fëmijëve pa aftësi të kufizuara: ata përballen me pengesa të konsiderueshme për të marrë shërbime shëndetësore dhe arsim, dhe kanë më shumë mundësi të përjetojnë abuzim, dhunë dhe praktika diskriminuese punësimi. Për më tepër, fëmijët me aftësi të kufizuara mendore kanë rrezik më të lartë për t'u konfliktuar me ligjin. Në të njëjtën kohë, ka disa pengesa për pjesëmarrjen e tyre të plotë në proceset ligjore: këto vijnë shpesh nga supozime negative për kapacitetet e tyre.

## Efektet e mundshme të diskriminimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

- Mungesa e autonomisë, përvoja e patronazhit të tepruar nga njerëz me aftësi të plota;
- Ndjesia e të qenit i perceptuar si një "objekt pa zë"
- Vështirësia në krijimin e një identiteti pozitiv vetjak si fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Përvoja e të qenit i izoluar (gjeografikisht, fizikisht dhe/ose nga shoqëria);
- Varësia;
- Ndjesia e të qenit i perceptuar si "aseksual"; dhe
- Cenueshmëria e lartë ndaj abuzimeve.



---

Për shkak të kësaj, profesionistët ligjorë shpesh duhet të ndërmarrin hapa shtesë për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tyre. Këto përfshijnë: zhvillimin e një sjelljeje pozitive dhe jo-diskriminuese dhe inkurajimi i profesionistëve të tjerë të bëjnë të njëjtën gjë; bashkëpunimi i fortë për të krijuar një marrëdhënie besimi; dhe advokimi që seancat gjyqësore të jenë miqësore me fëmijët dhe të aksesueshme. Profesionistët ligjorë duhet të sigurohen që fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, si p.sh: në shikim dhe dëgjim të kenë mundësi të përdorin mjete ndihmëse komunikimi që u nevojiten për të dhënë udhëzime, dëshmi ose për të marrë pjesë plotësisht në seancë.

Shumë fëmijë në kontakt me ligjin mund të bien viktima të diskriminimit, dhe duhet bërë çdo përpjekje e mundshme nga profesionistët ligjorë për ta rregulluar këtë, për shembull duke komunikuar me institucionet të të drejtave të njeriut ose ombudspersonin, apo duke nisur procese gjyqësore për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve për mosdiskriminim.

# UDHËZIMI 11: Mbajtja e fëmijëve të sigurt

## Profesionistët ligjorë duhet të ruajnë fëmijët dhe t'u mundësojnë të marrin pjesë në procese ligjore pa rrezikun e viktimizimit dytësor.

Të gjithë fëmijët mund të jenë në rrezik lëndimi si rezultat i përfshirjes në sistemin e drejtësisë. Fëmijët viktimë ose dëshmitarë të veprave penale mund të jenë në rrezik kërcënimi, hakmarrjeje, viktimizimi dytësor ose, në rastin më të keq, jeta e tyre mund të jetë në rrezik. Ky rrezik mund të jetë më i madh në raste të abuzimit seksual dhe rastet në të cilat fëmija i përfshirë është i vogël, është trafikuar, ka aftësi të kufizuara ose autori i krimit është i afërt me fëmijën. Profesionistët ligjorë duhet të jenë vigjilentë para rreziqeve të tilla dhe duhet të koordinohen me kujdes për të diskutuar masat mbrojtëse të nevojshme me punonjësit socialë, prokurorët dhe gjyqtarët.

Profesionistët ligjorë luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë së fëmijëve. Për të parandaluar stigmatizimin e fëmijës së pandehur, ata mund të kërkojnë që identiteti i fëmijës të mos bëhet publik dhe që seancat dëgjimore të jenë me dyer të mbyllura. Për të mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët nga kërcënimet dhe hakmarrjet, ata mund të kërkojnë që gjykata të urdhërojë masa që garantojnë sigurinë e fëmijës, si për shembull: duke dhënë dëshmi nëpërmjet audios, videos ose lidhjes televizuale, duke e dhënë dëshminë përpara fillimit të seancës gjyqësore, duke vendosur ekrane që pengojnë pamjen e fëmijës në sallën e gjyqit dhe mënjanojnë kontaktin me dhunuesin ose duke kërkuar që autori i krimit të largohet nga salla e gjyqit teksa jepet dëshmia. Avokatët gjithashtu mund të kërkojnë që gjykata të lëshojë urdhra kufizimi ndaj dhunuesve ose që ndaj tyre të vendoset arresti në burg si masë sigurie. Përpara se të japë dëshminë, avokati mund të kërkojë që fëmija të qëndrojë në një dhomë pritjeje të veçantë.

Mund të jetë e vështirë nëse fëmija refuzon të bashkëpunojë me mekanizmat proceduralë të ofruar për mbrojtjen e tyre. Në situata të tilla, profesionistët ligjorë duhet të respektojnë pikëpamjet dhe mendimet e fëmijëve, por edhe të përdorin marrëdhënien e besimit për të ndikuar që fëmijët të veprojnë sipas interesit të tyre më të lartë. Kur nevojitet, profesionistët ligjorë duhet t'i referojnë fëmijët klientë pranë burimeve mbështetëse, si: këshillimi për azil, konsulencë ose këshilla për kujdesin ndaj shëndetit. Ata duhet të kenë në dispozicion një listë të plotë dhe të përditësuar të organizatave vendore ose kombëtare që mund të ofrojnë ndihmën e përshtatshme.

# UDHËZIMI 12: Bashkëpunimi me të tjerët

## Një profesionist ligjor duhet të bashkëpunojë me organizata të tjera, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

Avokatët duhet të bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë për të garantuar respektimin e të drejtave të fëmijës. Profesionistët e tjerë mund të përfshijnë punonjësit e policisë, prokurorët, gjyqtarët, përkthyesit, punonjësit socialë, psikologët, nëpunësit e gjykatës, mësuesit, stafin mjekësor, nëpunësit e strehimit, e kështu me radhë. Profesionistët e tjerë ndonjëherë i shohin më shumë profesionistët ligjorë si agresivë e sulmues në qasjen e tyre të përfaqësimit të fëmijëve, sesa bashkëpunues. Megjithatë ata luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit të ngushtë midis profesionistëve që punojnë me fëmijët kështu që të gjithë palët e përfshira të kuptojnë plotësisht fëmijën dhe nevojat e tij/saj dhe të punojnë së bashku për të garantuar të drejtat e tyre. Në të njëjtën kohë, parimi i konfidencialitetit nuk duhet shkelur pa pëlqimin e shprehur dhe të informuar të fëmijës. Në praktikë, kjo të thotë që profesionistët ligjorë duhet:

- ta dinë si funksionon sistemi dhe cilët janë aktorët e ndryshëm, dhe të jenë të aftë t'ia përshkruajnë rolet e tyre fëmijës klient;
- të përcjellin pikëpamjet dhe mendimet e fëmijës te profesionistët e tjerë dhe ndërkohë të sigurohen që konfidencialiteti i fëmijës të ruhet, atëherë kur duhet;
- të jenë të informuar për ofruesit e shërbimeve që ndihmojnë fëmijët dhe shërbimet që ata ofrojnë;
- të shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet profesionistëve të tjerë dhe fëmijës; dhe
- të marrin pjesë në aktivitete trajnimi dhe takime ndër-disiplinore, të cilat mund t'i ndihmojnë avokatët të kuptojnë më mirë rolet e profesionistëve të ndryshëm që mbështetin fëmijët.

# BURIME DHE LEXIME TË MËTEJSHME

## Standarde dhe udhëzues ndërkombëtarë mbi qasjen e fëmijëve në drejtësi

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989)
- Protokollin jo i Detyrueshem i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës për Procedurën e Komunikimit (2011)
- Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Koment i Përgjithshëm 5 (2003): *Masat e Përgjithshme për Zbatimin e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës*, 27 nëntor 2003, CRC/GC/2003/5
- Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Koment i Përgjithshëm 10 (2007): *Të Drejtat e Fëmijëve në Drejtësinë Penale për të Miturit*, 25 prill 2007, CRC/C/GC/10
- Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Koment i Përgjithshëm 12 (2009): *E drejta e Fëmijës për t'u Dëgjuar*, 20 korrik 2009, CRC/C/GC/12
- Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Koment i Përgjithshëm 14 (2013): *E drejta e Fëmijës për t'iu marrë Interesat e Tij/Saj në Konsideratë si Parësore* (Neni 3(1), 29 maj 2013, CRC/C/GC/14
- Rregullat Standarde Minimale për Administrimin e Sistemit të Drejtësisë Penale për të Miturit (1985) (Rregullat e Pekinit)
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të cilëve iu është Hequr Liria (1990) (Rregullat e Havanës)
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit të të Miturit (1990) (Udhëzimet e Riadit)
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e Grave të Burgosura dhe Masat Alternative ndaj Burgimit për Gratë e Pandehura (2010) (rregullat e Bangkokut)
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara në Çështje që përfshijnë Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Veprave Penale (2005)
- Shënime Udhëzuese të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara: Qasja e Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë për Fëmijët (2008)
- Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Qasjen në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale
- Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut, Sesioni i 25-të, Të drejtat e Fëmijës: Qasja e Fëmijëve në Drejtësi, A/HRC/25/L.10, 25 mars 2014

## Standarde dhe udhëzues rajonalë mbi qasjen e fëmijëve në drejtësi

- Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të ndryshuar nga Protokollin 11 dhe 14, (1950)
- Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijët (2010)
- Direktiva 2010/64/EU mbi të Drejtën për Interpretim dhe Përkthim në Proceset Penale, 2010 (për fëmijë dhe të rritur)

- Direktiva 2012/13/EU mbi të Drejtën për Informim në Proceset Penale, 2012 (për fëmijë dhe të rritur)
- Direktiva 2013/48/EU mbi të Drejtën për të patur një Avokat në Proceset Penale, 2013 (për fëmijë dhe të rritur)
- Direktiva (BE) 2016/343 mbi Prezumimin e Pafajësisë dhe të Drejtën për të qenë i Pranishëm përgjatë Procedurave Penale, 2016 (për fëmijë dhe të rritur)
- Direktiva (BE) 2016/1919 mbi Ndhimën Juridike për Personat e Dyshuar dhe të Akuzuar në Çështje Penale, 2016 (për fëmijë dhe të rritur)
- Direktiva (BE) 2016/800 mbi Garancitë Procedurale për Fëmijët e Dyshuar ose të Akuzuar në Çështje Penale, 2016 (kushtuar posaçërisht fëmijëve në konflikt me ligjin)

### **Udhëzues të Posaçëm për Profesionistët Ligjorë**

- *Parimet bazë mbi Rolin e Avokatëve*, miratuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve, Havana (Kubë), 27 gusht deri më 7 shtator 1990
- *Parimet Ndërkombëtare të Sjelljes në Profesionin e Avokatit*, Dhoma Ndërkombëtare e Avokatisë (2011)
- *Udhëzime për Fëmijët në Kontakt me Sistemin e Drejtësisë*, Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve dhe Magjistratëve të të Fëmijëve dhe Familjeve (2017)
- *Manual Praktik për Avokatët: Si të Mbrosh një Fëmijë në Konflikt me Ligjin?* Mbrojtja Ndërkombëtare për Fëmijët (2018)

### **Lexime të mëtejshme**

- *Drejtësia miqësore për Fëmijët: Këndvështrimet dhe përvojat e fëmijëve të përfshirë në procedurat ligjore si viktime, dëshmitarë ose palë në nëntë Shtete Anëtare të BE-së*, Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (2017)
- *Drejtësia miqësore me fëmijët: Këndvështrimet dhe përvojat e profesionistëve mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në procedura ligjore civile dhe penale në 10 Shtete Anëtare të BE-së*, Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (2015)
- *Mundësi të Barabarta për Fëmijët për të Marrë Drejtësi, Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Azia Qendrore*, UNICEF Gjenevë, (2015)
- *Ndihma Juridike Miqësore për Fëmijët në Afrikë*, UNDP, UNICEF dhe UNODC (2011)
- *Dymbëdhjetë, e Drejta e Fëmijëve për të Marrë Pjesë në Sistemin e Drejtësisë Penale për të Mitur: Teori dhe Praktika për Zbatim*, Mbrojtja Ndërkombëtare për Fëmijët (2016)
- *Qasja në Drejtësi për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara*, Qendra Për Advokimin e Aftësive të Kufizuara Mendore (2015)
- *Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Profesionistët dhe Politikëbërësit për Drejtësinë në Çështje që përfshijnë Fëmijët Viktime dhe Dëshmitarë në Vepra Penale* (2009).





unicef  | for every child

**United Nations Children's Fund**  
Regional Office for Europe and Central Asia

Palais des Nations, CH-1211 Geneva 10,  
Switzerland  
Phone: +41 22 909 5111  
Email: [ecaro@unicef.org](mailto:ecaro@unicef.org)  
[www.unicef.org/eca/](http://www.unicef.org/eca/)